

## TERMAT E REFERENCËS

POZITA	TRAJNER PËR IMPLEMENTIMIN E NËN-GRANTEVE
LLOJI I KONTRATËS	Kontratë shërbimi
KOHËZGJATJA	Deri në 30 ditë
AFATI PËR APLIKIM	1 shkurt 2019
NR. I POZITAVE	1

## A RRETH PROJEKTIT

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS, në partneritet me Lens dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES) është duke implementuar projektin “GrassRoots Action Support”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti synon të ngritë kapacitetet ekzistuese të OSHC-ve në nivel lokal në Kosovë dhe t'i ndihmojë ato të përfaqësojnë interesat e komunitetit duke u ofruar mbështetje financiare dhe jofinanciare. Projekti do të lehtësojë të kuptuarit e OSHC-ve për proceset e politikave, për institucionet dhe aktorët e tjerë relevant me qëllim që t'u mundësohet atyre që të angazhohen në mënyrë efektive në dialogun dhe proceset e politikave publike në nivel lokal dhe qendror. GRAS do të ofrojë mbështetje financiare për OSHC-të në nivel lokal në mënyrë që të rrisë angazhimin e tyre në proceset e politikëbërjes, por gjithashtu edhe të krijojë partneritete në sektorin e shoqërisë civile për zë më të lartë në përfaqësimin e komuniteteve ose grupeve të tyre të interesit. Përveç përkrahjes financiare, projekti do të ofrojë trajnime dhe mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve me bazë në komunitet në mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre teknike për angazhim në politikëbërje, aftësitë e menaxhimit të projekteve, kapacitetet qeverisëse dhe organizative por gjithashtu t'u ndihmojnë atyre në ngritjen e aftësive për sigurim të fondeve

Projekti ka dy objektiva specifike: 1) të përmirësojë të kuptuarit e OSHC-ve për proceset e politikave dhe të institucioneve e akterëve të tjerë relevantë për t'u mundësuar atyre që në mënyrë efektive të angazhohen dhe të bashkëpunojnë me institucionet qeveritare, veçanërisht në nivel lokal; dhe 2) të zhvillojë kapacitetet e OSHC-ve me qëllim që të rritet në mënyrë efikase pjesëmarrja e tyre në procesin e hartimit të politikave.

## B DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

### Qëllimi dhe përmbajtja e punës

Trajnimi është një komponentë e mbështetjes jofinanciare, e cila do të ofrohet për organizatat përfituese të granteve të “GrassRoots Action Support”. Sesionet e trajnimit do të organizohen me qëllim që këtyre organizatave t'u ofrohen udhëzime dhe ndihmë në zbatimin e aktiviteteve të tyre të financuara nga GRAS.

Trajnimi do të përqendrohet në zbatimin praktik të aftësive në fushat e renditura më poshtë gjatë zbatimit të aktiviteteve të financuara nga GRAS:

- Menaxhimi i projektit dhe shkrimi i propozimeve të projekteve;
- Menaxhimi dhe raportimi financiar;
- Promovimi i aktiviteteve dhe komunikimi me komunitetin.

Trajnimi do të realizohet në grupe në pesë rajone të Kosovës. Nga një sesion trajnimi do të organizohet për çdo rajon.

## C PERIUDHA E KONTRATËS

Caktimi i Trajnerit është planifikuar për periudhën ndërmjet fillimit të shkurtit dhe fundit të qershorit 2019, për një total prej 10 ditësh pune. Dëshmia e orëve të punës të përfunduara do të paraqitet në formën e timesheets të nënshkuara dhe vlerësimeve të përfituesve mbi sesionet e mbajtura të trajnimit.

## D KRITERET E PËRZGJEDHJES

- Të paktën 5 vjet përvojë pune në pozita të lidhura me menaxhim projektsh, financa, dhe marrëdhënie me publikun në sektorin e shoqërisë civile;
- Aftësi të shkëlqyera në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe serbe, gjuha angleze është përparësi;
- Aftësi të larta në përdorimin e mjeteve dixhitale të komunikimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes;
- përvojë paraprake në ofrimin e trajnimeve;
- Niveli i lartë i aftësive organizative dhe të menaxhimit të kohës